



# Republika e Kosovës

Komuna e Malishevës



Drejtoria Për Arsim dhe Edukim

Nr: 11/204

Më:20.03.2017

Në bazë të nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës, nr. 03/L-212,( Gzeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.90/2010), Neni 5 pikës c. të Ligjit për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, nr. 03/L-068, dhe shkresës nga Ministria e Financave Departamenti i buxhetit me nr.156 datë; 22.02.2017. Drejtoria për Arsim dhe Edukim shpall:

## KONKURS

*Për plotësimin e vendit të punës*

Nr.	Niveli, Shkolla	Pozita	Vendi i lirë/zëvendësim	Numri i pozitave	orë
1	SHFMU" Hasan Prishtina" Terpezë	Arsimtar/e klasore	i lirë	1	20
2	SHFMU" Vesel Pagarusha" Pagarushë	Edukatore	Zëvendësim i lehoniosë	1	20
3	SHFMU" Ismail Qemali" Bellanicë	Arsimtar/e klasore	Zëvendësim i lehoniosë	1	20

### I. Aplikacionit i bashëngjiten këto dokumente:

- Formulari i aplikimit
- Rezymeja personale (CV)
- Dokumenti personal( letërnjoftimi ose pasaporta)
- Diplomat e kualifikimit( ose certifikatat), certifikatat në vend të diplomes duhet të jenë jo më të vjetra se gjashtë muaj.
- Çertifikata që nuk jeni nën hetime
- Dëshmi të përvojës në institucionet arsimore ( nëse ka)

### II. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit mësimor

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktura me akte juridike që e rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar.

### **Kriteret e kualifikimit për arsimtar/e klasor**

- Fakulteti i Edukimit-programi fillor dhe
- Fakulteti i Mësuesisë.

### **Kriteret e kualifikimit për edukatore**

- Fakulteti i Edukimit -programi Parashkollor;
- Shkolla e Lartë Pedagogjike –drejtimi për edukator;
- Fakulteti Filozofik-dega e Pedagogjisë;
- Fakulteti i shkencave Sociale-programi përkujdesja dhe mirëqenja e fëmijëve.

**SQARIM:** Në institucionet e arsimit të fillor (parafillor ,1-5), kandidatët duhet të kenë së paku 240 ECTS, përkatësisht 4 vjet.

Vetëm në mungesë të kandidatëve nga sqarimi i lartcekur, do të shqyrtohen dhe aplikacionet e kandidatëve me kualifikim të përafërt.

Kandidatët me kualifikim jo përkatës dhe ata të pakualifikuar sipas këtyre ligjeve dhe Udhëzimeve administrative nuk do të merren në shqyrtim, përkatësisht refuzohen.

**III. Mosplotsimi i saktë dhe i qartë i formularit të aplikimit, aplikacionet e pakompletuar dhe ato që dorëzohen pas afatit të konkursit nuk do të merren në shqyrtim, përkatësisht refuzohen.**

Si informata të sakta dhe të verteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente( jo ata që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi)

Përsoneat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të jenë të nostifikuar diplomat nga MASHT.

**Për intervistë do të ftohën ata kandidat të cilët i plotësojnë kushtet sipas akteve ligjore të cekura.**

Lista e ngushtë e aplikantëve që ftohen për intervistë dhe orari i intervistave publikohet në web faqen e Komunës së Malishevës.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë kopje dhe ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen me rastin e intervistimit.

### **Afati dhe mënyra e aplikimit**

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik, duke filluar nga data e publikimit më:**20.03.2017 deri më datën 03.04.2017**

Aplikacioni i kompletuar (me të gjitha dokumentet e kërkura) duhet të dorëzohet përmes protokolit,përkatësisht përmes zyrës së pritjes së palëve, në objektin e ri të Komunës së Malishevës.